

PËRMBAJTJA

- Projekti “Transparenca e Pushtetit Vendor”	2
- Rëndësia e transparencës në qeverisje	2
- Strategji për promovimin e transparencës	4
1. Vlerësimi dhe monitorimi	4
2. Aksesit i informacionit	5
3. Etika dhe integriteti	11
4. Reforma Institucionale	14
5. Synimi në çështje të caktuara	17

Projekti “Transparenca e Pushtetit Vendor”

“Transparenca e Pushtetit Vendor” është një projekt i Transparency International Albania, i financuar nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC).

Qëllimet kryesore të këtij projekti janë :

- Rritja e transparencës së pushtetit vendor ;
- Stimulimi i qeverisjes së mirë dhe transparencës ;
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për rëndësinë e transparencës dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje.

Si i tillë, projekti tenton të sjellë një traditë në monitorimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të pushtetit vendor përbri luftës ndaj korrupsionit.

Duke patur në fokus qytetarin dhe shërbimet që i ofrohen atij, ky projekt tenton të arrijë një sjellje më transparente të organeve vendore në ofrimin e shërbimit ndaj publikut, dhe rritjen e ndërgjegjësimit të këtij të fundit për mbrojtjen e të drejtave të tij dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje.

Projekti synon të krijojë një infrastrukturë të qëndrueshme informimi për qytetarët. Si i tillë, do të këtë në vëmendje të tij zhvillimin e një tradite vlerësimi dhe stimulimi të kujtdo që kontribuon për transparencën e administratës publike përballë qytetarit dhe qeverisjen e mirë.

Transparency International Albania synon të krijojë një metodologji me vazhdimësi në këtë sferë të luftës ndaj korrupsionit, duke aplikuar projekte të ngjashme edhe në bashki të tjera në vend.

Rëndësia e transparencës në qeverisje

Transparenca e institucioneve publike vendore është baza për të rritur përgjegjshmërinë e këtyre institucioneve ndaj qytetarëve. Meqënëse janë qytetarët, ata që kontribuojnë me paratë e tyre në funksionimin e këtyre organizmave, atëherë vetë interesi publik për t'u informuar rreth mënyrës së shpenzimit të tyre është mjaft i madh. Aksesit në të dhënat zyrtare bën të mundur evidentimin e mangësive të mundshme të efikasitetit në qeverisje, duke krijuar mundësi vlerësimi dhe përmirësimi për një menaxhim sa më të mirë të shërbimeve apo aseteve publike.

Çfarë kuptojmë me qeverisjen e mirë vendore?

Termi “qeverisje” përkufizohet sipas UNDP (Programit Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara) si: “ushtrimi i autoritetit ekonomik, politik dhe administrativ për të menaxhuar çështjet e vendit në të gjitha nivelet. Këtu përfshihen mekanizma, procese dhe institucione, nëpërmjet të cilave qytetarët dhe grupet shprehin interesat e tyre, ushtrojnë të drejtat e tyre ligjore dhe përmbushin detyrimet e tyre”.

Dy janë aspektet e këtij definicioni, të cilat meritojnë më tepër vëmendje:

Së pari, koncepti i qeverisjes është më i gjerë se qeveria. Qeverisja është përshkruar normalisht si përfshirëse e qeverisë, shoqërisë civile dhe sektorit privat. Në kontekstin e qeverisjes vendore, kjo nënkupton që, përgjegjësia për menaxhimin e punëve të qytetit nuk është e kufizuar vetëm

tek autoritete vendore, por përfshin disa lloje të grupeve të interesit si: autoritetet qendrore dhe vendore, qeverite, sektorin privat, organizata joqeveritare, median, shoqatat profesionale dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile.

Së dyti, koncepti i qeverisjes, që fokusohet tek institucionet dhe proceset. Transparenca në procesin vendimmarrës dhe në institucione ka potencialin për t'u bërë pjesë qendrore e një strategjie për angazhimin e palëve të interesuara, luftën kundër korrupsionit dhe përmirësimin e cilësisë së qeverisjes vendore në tërësi.

Në kontekstin aktual, qeverisja e mirë vendore na paraqet një situatë, në të cilën mekanizmat, procedurat dhe instrumentat për vendimmarrje apo shërbime, lehtësojnë pjesmarrjen qytetare dhe rrisin përgjegjshmërinë.

Transparenca si parim për një qeverisje të mirë urbane

Transparenca është gjerësisht e njohur si një parim bazë për një qeverisje të mirë. Ajo nënkupton “shkëmbimin e informacionit dhe veprimin në një mënyrë të hapur”. Për më tepër, transparenca nxit palët e interesuara për të mbledhur informacione që mund të jenë kritike për të zbuluar abuzimet dhe për të mbrojtur interesat e tyre.

Sistemet transparente parashikojnë procedura të qarta për vendimmarrjen publike dhe kanalet e hapura të komunikimit ndërmjet palëve të interesuara e zyrtarëve, si dhe mundësojnë një seri të gjerë informacioni. Aksesin e lirë ndaj informacionit luan një rol të rëndësishëm në promovimin e transparencës. Informacioni, gjithsesi, duhet të jetë në kohë, i rëndësishëm, i saktë dhe i plotë për tu përdorur efektivisht.

Transparenca dhe angazhimi qytetar

Angazhimi qytetar nënkuptohet si një pjesëmarrje aktive në jetën e qytetarëve dhe në kontributin e tyre. Niveli i besimit në pushtetin lokal përbën një faktor kryesor që përcakton masën dhe cilësinë e angazhimit qytetar.

Besimi në organet publike ndikohet nga dy faktorë: nga cilësia e shërbimit që marrin individët dhe familjet e tyre, dhe nga fakti se sa transparente e të ndershme janë autoritetet në lidhje me performancën e tyre, duke përfshirë gadishmërinë e tyre për të pranuar dhe për të mësuar rreth gabimeve të tyre.

Transparenca nuk ndihmon vetëm në informimin e publikut në lidhje me zhvillimin e ideve dhe propozimeve, por edhe për të bindur qytetarët se agjensitë publike janë të interesuara në dëgjimin e pikëpamjeve të tyre dhe përgjigjen e prioritetëve të qytetarëve. Kjo nga ana tjetër rrit legjitimitetin e procesit të vendimmarrjes dhe forcon “demokracinë e drejtpërdrejtë”.

Transparenca gjithashtu ndikon në angazhimin qytetar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Qeveritë lokale duhet të ndajnë vlerësimet dhe planet e tyre me qytetarët si edhe të kërkojnë pikëpamjet e tyre mbi baza të rregulta të cilat mund të jenë shumë efektive në zbatimin e programeve të zhvillimit si edhe me pjesëmarrjen e palëve të interesuara. Në këtë mënyrë, në përputhje me rolin e ndryshimit pushteti lokal shërben si nxitës dhe udhëheqës, si ofrues dhe kontrollues i mallrave dhe shërbimeve urbane.

STRATEGJI PËR PROMOVIMIN E TRANSPARENCËS

Për të promovuar transparencën dhe qeverisjen e mirë në nivel lokal, Transparency International Albania propozon një strategji të fokusuar në 5 drejtime kryesore, që njëkohësisht zvogëlojnë dhe efektet negative të korrupsionit.

1. Vlerësimi dhe monitorimi

Me anë të tyre mund të kuptosh llojet dhe shkallën e korrupsionit, si edhe shkallën e transparencës në pushtetin lokal, duke krijuar kështu bazat me anë të të cilave mund të matet progresi i arritur në këtë drejtim. Kjo strategji, është gjithashtu e vlefshme për të rritur ndërgjegjësimin e publikut, si edhe për të mobilizuar palët e angazhuara në trajtimin e korrupsionit. Kjo metodë mund të realizohet nëpërmjet vlerësimit që vetë institucioni mund t'i bëjë performancës së tij. Kështu mënyra më e mirë do të ishte caktimi i një grupi pune i cili do të hartojë një sërë indikatorësh, të cilët më pas të përfshihen në një formular vlerësimi dhe monitorimi.

Qëllimi i kësaj metode:

- Identifikimi dhe fokusimi i atyre shërbimeve që mund të jenë lehtësisht pre e abuzimeve nga autoritetet, si edhe i burimeve që menaxhohen nga njësia vendore;
- Të krijohen bazat për mbledhjen e një informacioni më të zgjeruar rreth punës së njësive vendore, në mënyrë që të rritet efektiviteti. Shpërndarja e këtij informacioni nxit më tej transparencën ndaj publikut.

Aplikimi i formularit të vlerësimit bën të mundur mbledhjen e një informacioni të rëndësishëm dhe mjaft konkret, duke qënë se arrihet nëpërmjet ndërveprimit të drejtëpërdrejtë me zyrtarët dhe punonjësit e njësive së qeverisjes vendore. Ky formular duhet të përmbajë një sërë pyetjesh të ndara në seksione, në varësi kjo të llojit të shërbimeve që ofrohen për qytetarin. Administrimi i këtij procesi duhet të realizohet nga një grup pune, ku të përfshihen dhe përfaqësues të biznesit, shoqërisë civile dhe të komunitetit. Nga analiza që do të bëhet në fund të tij, do të arrihet të identifikohen mangësitë në shërbimin që ofrohet për qytetarët apo rastet e praktikave korruptive brenda administratës, të cilat kanë nevojë për një përmirësim. Pas eksperiencës së parë, realizimi i këtij vlerësimi në intervale kohore të caktuara do të shërbejë si bazë për të monitoruar në vetvete progresin e bërë nga njësia vendore në dhënien e shërbimeve për qytetarët, si edhe do të rrisë më tej nivelin e transparencës.

2. Akses i informacionit

Është e nevojshme të merren masa për të përmirësuar aksesin e informacionit nga ana e palëve të interesuara (qytetarët apo grupet e interesit), në mënyrë që ata të marrin pjesë në vendimmarrje më efektive. Metodat më të mira për realizimin e këtij shërbimi janë:

2.1 Pjesëmarrja publike

Pjesëmarrja publike është e lidhur ngushtë me transparencën në qeverisje. Në mënyrë të qartë kjo ndikon te qytetarët në rritjen e besimit ndaj organeve qeverisëse.

Niveli i pjesëmarrjes së komunitetit varet nga shpërndarja e informacionit dhe angazhimit të qytetarëve në zbatimin dhe menaxhimin e projekteve dhe shërbimeve nga njësi e qeverisjes vendore përkatëse.

Qëllimet e kësaj metode janë të qarta;

- nxit transparencën dhe krijon bazat për një model qeverisjeje vendore të hapur ndaj komunitetit;
- inkurajon qytetarët që të jenë më të angazhuar në proceset vendim marrëse që kanë një ndikim në komunitetin e tyre;
- shërben për të çuar përpara të kuptuarit nga ana e qytetarëve mënyrën e ushtrimit të funksioneve zyrtare nga autoritetet;
- i ofron publikut mundësi që të ndikojë dhe të marrë pjesë në zhvillimin e programeve dhe projekteve për zonën ku ata banojnë.

Pjesëmarrja publike synon tejkalimin e hendekut në mes autoriteteve vendore, shoqërisë civile, sektorit privat dhe publikut të gjerë, duke nxitur përgjegjshmërinë dhe transparencën ndaj tyre.

Pjesëmarrja publike mund të marrë forma të ndryshme. Disa nga mjetet që kanë një rol specifik në rritjen e transparencës nëpërmjet nxitjes së pjesëmarrjes publike janë përmbledhur më poshtë:

❖ *Mbledhjet e hapura për Takimet publike*

Takimet publike kanë si objekt kryesor dhënien e informacionit dhe marrjen në konsideratë të pikëpamjeve të qytetarëve në planifikimin e politikave të ndryshme që i adresohen komunitetit. Këto takime mund të jenë një format i dobishëm për të diskutuar strategjinë e transparencës në qeverisjen urbane, e realizuar nëpërmjet diskutimeve në disa faza. Ato i mundësojnë pjesëmarrësve diskutimin e pikëpamjeve alternative për çështje specifike dhe shkëmbimin e ideve mbi to. Një tipar i rëndësishëm i takimeve publike është pjesëmarrja e një grupi të ndryshëm të individëve, që përfaqësojnë nivele të ndryshme arsimore dhe profesionale.

Takimet publike shërbejnë për të arritur synimet e mëposhtme:

- Për të siguruar një informacion më të mirë nga zyrtarët publikë për qytetarin, veçanërisht për vendime të rëndësishme që ndikojnë mbi ta, dhe për të lehtësuar pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të palëve të interesuara në qeverisjen vendore.
- Për të mundësuar ndjekjen nga publiku te veprimeve të ndërmarra nga ana e zyrtarëve publik, duke rritur kështu përgjegjshmërinë.

- Për të nxitur krijimin e marrëdhënieve më të mira mes të autoriteteve lokale dhe qytetarëve.

Proçesi i marrjes në konsideratë të mendimeve apo nevojave të publikut të gjerë, qoftë vullnetarisht apo si rezultat i detyrimeve ligjore, është dëshmi e një qeverisje transparente.

❖ **Bordet këshillimore të qytetarëve**

Strukturuar përgjithësisht rreth çështjeve të veçanta, te tilla si zhvillimit ekonomik ose të strehimit, këto borde mund të jenë një tjetër formë efektive e pjesëmarrjes publike. Bordet duhet të jenë të përbërë nga vullnetarë të komunitetit, të cilët i japin autoriteteve lokale informacion dhe rekomandime që kanë të bëjnë për çështjet lokale. Duke marrë parasysh shkallën e pavarësisë me të cilën qytetarët veprojnë në bordet këshillimore, ato mund të shërbejnë si një mbrojtje e dobishme kundër korrupsionit dhe mund të ndihmojnë në vendosjen e transparencës për praktikën vendimmarrëse.

❖ **Dëgjimet publike**

Seanca dëgjimore publike janë thelbësore për funksionimin e hapur dhe demokratik të administratës lokale. Dëgjimet publike nënkuptojnë diskutim apo debat publik për çështje që prekin komunitetin dhe mund të jenë çelësi i garantimit të transparencës në proçeset vendimmarrëse.

2.2 Ligji për informimin mbi dokumentet zyrtare*

E drejta e aksesit në dokumentet zyrtare është një e drejtë vitale, në një demokraci moderne. Si e tillë, kjo e drejtë, e parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, përcakton dhe vendos rregulla në mirëfunksionimin dhe transparencën e administratës publike, kundrejt publikut të gjerë, në veprimtarinë e saj të përditshme.

Kjo e drejtë, në vetvete, nënkupton të drejtën që ka çdo person për të njohur dhe për të studiuar dokumentet e mbajtura nga autoritetet publike.

Pjesëmarrja e publikut në diskutimet e informuara mbi çështjet e interesit të përgjithshëm publik, është një nga kërkesat parësore të demokracisë.

Kjo mënyrë funksionimi kërkon që qytetarët të jenë të vetëdijshëm në ushtrimin e kontrollit mbi administratën, me qëllim që të nxitin eficiencën e saj dhe të luftojnë korrupsionin.

Një demokraci, pra, duhet të sigurojë, hapje ose transparencë në administrimin publik dhe të garantojë të drejtën e informimit të publikut me dokumentet zyrtare.

* Citim nga kumtesa Dokumenti zyrtar dhe ligji “Për të drejtën e informimit” e Alket Jaupi, përfaqësues i institucionit të Avokatit të Popullit, në Konferencën Kombëtare “E drejta e informimit e drejtë themelore e njeriut”, <http://www.avokatipopullit.gov.al/Raporte/Konf2002.pdf>

Në këtë kuadër, transparenca e veprimtarisë së organeve të administratës publike, i jep të drejtë dhe aftëson qytetarët të marrin pjesë më afër, në proçesin e vendimmarrjes dhe, në të njëjtën kohë, përmirëson mbështetjen dhe eficiencën e institucioneve publike.

Momentet kryesore në të cilat mbështetet parimi i aksesit publik në dokumentet zyrtare janë:

1. lehtësimi i shkëmbimit të pikëpamjeve të lira demokratike, duke kontribuar kështu në ligjshmërinë demokratike të vendimeve;
2. forcimi i kontrollit të administratës nga publiku dhe media dhe

3. kontributi në bërjen e administratës më efçente.

Aksesi në dokumentet zyrtare, duhet të konsiderohet si një nga shtyllat e shkëmbimit të pikëpamjeve të lira demokratike.

Nevoja e informimit të publikut me këto dokumente, e sheh të pamjaftueshëm informacionin e dhënë nga vetë autoritetet publike rreth punës së tyre, pasi, pikërisht informacioni, i lejon njerëzit të shqyrtojnë veprimet e një qeverie dhe është baza për debatin e duhur dhe të informuar mbi ato veprime.

Kjo nevojë, si kusht, parasheh qenien e aktiviteteve publike të hapura për qytetarët dhe median, në mënyrë të tillë që ata të mund të zgjedhin informacionin që dëshirojnë dhe ta marrin atë, pa pasur nevojën e mbështetjes për këtë qëllim, nga shërbimet e informimit publik. Për këtë, të gjithë nëpunësit civilë duhet të jenë të vetëdijshëm që, si rregull, dosjet dhe dokumentet zyrtare t'u bëhen të ditura çdokujt.

Megjithatë kjo e drejtë kufizohet në dy mënyra:

- Publiku ka të drejtë të studiojë vetëm ato lloje dokumentesh që vlerësohen si dokumente zyrtare dhe, në këtë kuptim, vetëm ato dokumente që kanë marrë apo përpiluar autoritetet publike, janë zyrtare.

- Informacioni i përmbajtur në një dokument zyrtar, mund të jetë sekret. Sipas përcaktimit ligjor përkatës për këtë term, bëhen edhe kufizimet përkatëse. Në këtë përkufizim përfshihen edhe rastet kur dokumenti përmban të dhëna personale të një personi të tretë, të cilat janë të mbrojtura me ligj, përsa i përket bërjes së tyre publike.

Me gjithë kufizimet e mësipërme, kjo e drejtë dhe ushtrimi i saj, ul rrezikun e veprimit arbitrar dhe, për më tepër, sikurse edhe përmendet shpesh, e drejta e informimit me dokumentet zyrtare dhe ushtrimi i saj, kontribuojnë në kthimin e korrupsionit në një dukuri të rrallë, në administratën publike. Sipas ligjit institucioni përgjegjës që kujdeset për zbatimin e tij është Avokati i Popullit.

2.3 Qeverisja Elektronike (E-Government)

Interneti ka hapur mundësi të reja për qeverinë dhe autoritet lokale për tu lidhur me qytetarët. Shumë autoritete lokale – si ato të vendeve të zhvilluara si ato në zhvillim - kanë hapur faqe interneti për qytetet e tyre. Shumë nga këto institucione kanë shkuar dhe me tutje për të përdorur internetin për shërbime të ndryshme me qytetarët.

E-Government përbën një nga indikatorët kryesorë të përdorur nga shoqëria civile dhe individët për të monitoruar performancën e qeverisjes vendore dhe nivelin e transparencës.

Qëllimi i këtij mjeti është:

- Rritja e informacionit në dispozicion të publikut të gjerë për aktivitet e pushtetit lokal;
- Maksimizimi i potencialit të rrjeteve dhe lejimi i bashkëveprimit sa më të shpejtë midis publikut të gjerë dhe autoriteteve.

Informacioni i vendosur në internet është i hapur për çdo person që di të shkruaj dhe të lexoj dhe që ka mundësinë e përdorimit të internetit. Sigurisht që është vullneti politik që bën të mundur vënien në dispozicion të informacionit të caktuar, duke siguruar një informacion të përgjithshëm apo të veçantë për palët e interesuara.

E- Government përdor internetin për të shpërndarë më shpejt informacionin. Ajo kërkon një angazhim nga autoritetet e qeverisjes lokale ose nga kompania menaxhuese për të siguruar përditësimin në mënyrë të vazhdueshme të informacionit. Në këtë aspekt ajo kërkon burime njerëzore dhe financiare, si dhe aftësi profesionale nga ana e personave përgjegjës.

Përdorimi i E- Government mund të jetë veçanërisht i dobishëm për:

- Ofrimin e informatave të përgjithshme mbi një qytet;
- Publikimin e njoftimeve të ndryshme;
- Raportimin e ankesave, shqetësimeve dhe emergjencave nga komuniteti lokal;
- Aplikimin për marrjen e llojeve të ndryshme të lejeve apo liçencave nga ana e qytetarëve;
- Zhvillimin e një procedurë të hapur tenderimi.

2.4 Trainimi i medias

Advokimi, sensibilizimi dhe trajnimi në fushën e qeverisjes urbane në përgjithësi, dhe transparenca në veçanti, ende kërkojnë shumë vëmendje në shumicën e vendeve në zhvillim. Media ka luajtur gjithmonë një rol të madh në plotësimin e këtij boshllëku për shkak të kapacitetit të saj unik për të informuar si publikun, ashtu edhe politikbërësit. Është e rëndësishme të theksohet, se efektiviteti i mediave varet nga aksesimi që kanë mbi informacionin, liria e shprehjes, si dhe nga kuadri profesional dhe etik i gazetarëve. Kapacitetet e medias duhet të forcohen vazhdimisht nëpërmjet mënyrave të ndryshme të trajnimit, në mënyrë që të ndikojnë më tepër në çështjet e rritjes së transparencës dhe përgjegjesisë së autoriteteve vendore, ashtu dhe në uljen e nivelit të korrupsionit.

Ky proces luan rol të rëndësishëm në:

- Krijimin e vetëdijes dhe rritjen e të kuptuarit të medias mbi çështjet përkatëse të transparencës dhe qeverisjes së mirë – duke përfshirë dhe detyrimin e llogaridhënies së autoriteteve;
- Forcimin e besueshmërisë dhe aftësisë së mediave në sigurimin e paanshëm të informacionit dhe në denoncimin e akteve korruptive;
- Ofrimin e mundësive për krijimin e rrjeteve në mes mediave dhe profesionistëve të ndryshëm për problemet e transparencës dhe pjesëmarrjes në qeverisje.

Trajnimi mund të marrë forma të ndryshme, dhe mund të kryhet nga një agjenci qeveritare ose nga një organizatë e shoqërisë civile. Format e trajnimit mund të përfshijnë: seminare, takime teknike, forume diskutimi për shkëmbimin e ideve dhe përvojave, udhëzues praktik apo manuale trajnimi. Një trajnim i tillë duhet të përfshijë përpjekjet për të zhvilluar dhe zbatuar standartet të një sjelljeje etike dhe profesionale për mediat.

Media luan një rol jetik në mbrojtjen e parimeve të qeverisjes së mirë vendore, duke përfshirë edhe transparencën, si dhe në identifikimin e parimeve të tilla. Trajnimi i medias mund të ndihmojë për të krijuar një grup gazetarësh të cilët të angazhohen për identifikimin e praktikave të mira, si dhe të këqija të qeverisjes, duke i vlerësuar ato me objektivitet. Një komunitet i mirëinformuar nga media krijon themelet për ekzistencën e transparencës në qeverisje, si edhe bën të mundur një angazhim më të madh qytetar në qeverisjen lokale.

2.5 Mjetet e edukimit publik

Edukimi i publikut ndërton besimin publik dhe i përfshin qytetarët në jetën politike, sociale, si edhe

në vendimmarrjet që koordinojnë strategjitë antikorrupsion. Edukimi i publikut demonstron me një angazhim nga ana e qeverisë dhe të aktorëve të tjerë të komunitetit për tu angazhuar aktivisht dhe potencialisht për të riformuar strukturat dhe praktikave të qeverisjes së dobët. Edukimi i publikut përfshin jo vetëm të drejtat dhe detyrimet formale të palëve të interesuara, por edhe fushatat e edukimit publik për ndërtimin e vetëdijes për problemet dhe zgjidhjet në lidhje me qeverisjen. Publiku luan një rol kritik në vlerësimin e efektivitetit të qeverisjes vendore dhe transparencës. Një pjesë e rëndësishme e kësaj metode është informimi dhe pjesëmarrja e fëmijëve në politikën e qeverisjes vendore.

Qëllimi

- Lehtësimi i pjesëmarrjes së një publiku të informuar në politikën e qeverisjes lokale, përmes edukimit adekuat dhe informimit mbi çështjet me rëndësi.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe kërkesës për përgjegjësi publike ndaj autoriteteve.

Edukimi publik është një bllok kryesor ndërtimi në rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë në strukturat e qeverisjes lokale.

Edukimin i publikut, lidhur me rëndësinë e transparencës në qeverisje, përbën një ndërmarrje afatgjatë, pasi përfshin jo vetëm efektet negative të dukshme të praktikave korruptive, por i siguron publikut mjetet për të identifikuar dhe për të raportuar mashtrimet, korrupsionin dhe sjelljet joetike në administratë.

Në çdo aktivitet arsimor apo në terren, të ndërmarrë për këtë qëllim, duhet t'i kushtohet rëndësi interesave të publikut. Cilësitë dhe sofistikimi i metodave që mund të përdoren varen kryesisht nga burimet financiare dhe njerëzore të secilës njësi të qeverisjes vendore. Ndër to përmendim:

- **Median / Fushatat publicitare** : Pjesëmarrja e mediave në këtë proces është vendimtare. Ajo ofron një rrugë, si për arsimin publik po ashtu dhe në aksesin me informacionin. Mediat mund të jenë të dobishme në formulimin e programeve që i kushtohen çështjeve të qeverisjes së mirë, duke përfshirë transparencën dhe llogaridhënien. Me anë të shtrirjes së saj media është e dobishme në kultivimin e një kulture të ushtrimit të interesit publik dhe të debatit në çështjet e qeverisjes lokale nga qytetarët e komunitetit përkatës. Nga njëra anë, ajo mund të informojë dhe të lehtësojë pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, ndërsa nga ana tjetër, ajo mund të jetë efektive në ekspozimin e korrupsionit në qeverisje. Qeveria dhe komuniteti janë partnerë me median për të zhvilluar edukimin publik. Megjithatë media nuk ka nevojë të mbështetet vetëm në mundësi të tilla dhe duhet shpesh të marrë rolin udhëheqës në kanalizimin e informacioneve relevante për interesin publik. Inkurajimi i mirëinformimit të shoqërisë civile mund të realizohet nëpërmjet njoftimeve të shërbimeve publike, radio televizioneve lokale, medias sociale (facebook, twitter, blog) reklamave të shtypura, posterave etj.
- **Programet shkollore** : Siç u përmend më sipër, edhe fëmijët janë pjesëmarrës të nevojshëm në programet e edukimit publik. Kjo gjë arrihet si përmes aktiviteteve joformale shkollore, ashtu dhe përmes programit mësimor në shkollë, duke synuar ndërgjegjësimin dhe informimin e tyre lidhur me të drejtat dhe detyrimet si anëtarë të një komuniteti. Edukimi i fëmijëve është mjaft i rëndësishëm, në mënyrë që nesër ata të jenë qytetar të përkushtuar për një qeverisje të mirë.
- **Angazhimet për fjalime publike nga autoritetet qeverisëse** : Takimet me qytetarët, grupet e ndryshme të interesit, me biznesin dhe me organizata jofitimprurëse janë një përpjekje për edukimin e publikut. Megjithatë, një avantazh për këtë lloj angazhimi e

përbën mundësia jo vetëm e ofrimit të një mesazhi, por edhe për t'ju përgjigjur pyetjeve të publikut dhe shqetësimeve të tyre. Ka shumë mënyra për të krijuar këtë qasje si; krijimi i një zyre për marrëdhëniet me publikun ku mund të marrin pjesë zyrtarë të lartë, akademikë etj.

- **Publikimet** : Prodhimi i informacionit të shkruar për transparencën dhe strategjinë antikorruption mund të jetë një mjet efektiv për fushatën e edukimit. Publikimet mund të jenë të vlefshme në lidhje me aktivitete të tilla siç janë programet e trajnimit dhe edukimit për administratën. Po kështu, botimet e publikuara online në faqen zyrtare të internetit të secilës njësi qeverisëse, bëhen më të prekshme për publikun.

3. Etika dhe integriteti

Nevojiten mjete për të qartësuar atë ç'ka duhet të presim nga profesionistët, duke përfshirë këtu dhe mekanizma monitorimi, që të sigurojnë përmbushjen e angazhimeve të tyre, si edhe marrjen e masave në rastet e shpërdorimit të pushtetit të besuar.

Ndër mjetet e prezantuara në këtë seksion, tre të parat përbëjnë dispozita ligjore që synojnë ekzistencën e një sistemi transparent dhe të përgjegjshëm. Këto rregulla përcaktojnë procedurë që sigurojnë përgjegjshmërinë në dhënien e shërbimeve, si edhe luajnë një rol kyç në përmirësimin e besimit të qytetarëve në qeverisjen lokale.

Ndërsa mjetet e tjera, synojnë forcimin e etikës së qeverisjes së pushtetit lokal, duke propozuar ekzistencën e një kodi sjelljeje, zbatimin e tij në praktikë, si edhe realizimin e trajnimeve për njohjen e tij nga ana e administratës.

Më konkretisht këto mjete janë:

3.1 Ligji “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”

Për të parandaluar aktet korruptive që vijnë si pasojë e konfliktit të interesit dhe që mund të ndikojnë në vendimmarrjen publike, është konsideruar e nevojshme ekzistenca e dispozitave ligjore që rregullojnë paraprakisht këtë situatë. Është mjaft e rëndësishme të theksohet se këto dispozita ligjore janë aq efektive sa janë dhe sanksionet e parashikuara në të dhe zbatimi i tyre në praktikë.

Qëllimi

- Sigurimi i transparencës dhe i një sjelljeje etike të nënpunësve apo zyrtarëve publikë, në mënyrë që të shmanget çdo tundim për përfshirje në akte korruptive;
- Ekzistenca e dispozitave ligjore transparente dhe respektimi i tyre në vendimmarrje;
- Promovimi apo nxitja e deklarimit të konfliktit të interesit nga vetë zyrtarët apo nënpunësit publikë;
- Të krijojë garanci në eliminimin e çdo influence (shantazhi) të paligjshme, që lidhte me kriteret punësimin dhe qëndrimin në detyrë të nënpunësve shtetëror;
- Të sigurojë mekanizma sanksioni dhe ndëshkimi ndaj atyre që kryejnë shkelje sipas përcaktimeve të ligjit.

Ekzistenca e këtij ligji e promovon transparencën në princip, por zbatimi i tij përbën një sfidë në vetvete. Ai përcakton gjithashtu, procedurat që duhet të ndjekin subjektet e interesuara për të denoncuar rastet që lidhen me konfliktin e interesit, si edhe autoritetet që ngarkohen me monitorimin dhe zbatimin e tij. Për të garantuar më së miri zbatimin e tij, do të ndihmonte mjaft ngritja e një bordi specifik dhe të pavarur pranë çdo njësie të qeverisjes vendore, që të informojë apo asistojë subjektet e interesuara lidhur me mekanizmat që garanton ligji në fjalë.

3.2 Deklarimi i pasurisë dhe i burimit të të ardhurave.

Deklarimi i pasurisë dhe i burimit të të ardhurave përbën një temë delikate, por është mjaft i rëndësishëm për të garantuar përgjegjshmërinë e zyrtarëve. Kërkesat për deklarim na japin mundësi të kemi informacion mbi të ardhurat dhe ndryshimet e pasurisë së subjekteve gjatë kohës që ushtrojnë funksione publike, kjo si për përfaqësuesit e zgjedhur ashtu edhe për nënpunësit e pushtetit vendor. Vendi ynë ka një ligj specifik që bën përcaktimin e rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta.

Qëllimi

- Garanton bazat ligjore për monitorimin e pasurisë së zyrtarëve gjatë ushtrimit të funksioneve publike;
- Rrit përgjegjshmërinë e veprimeve të zyrtarëve dhe redukton mundësitë për përfshirjen e drejtpërdrejtë apo nxitjen e praktikave korruptive që lidhen me funksionet që ata ushtrojnë.

Për të patur një zbatim sa më efektiv të këtyre normave, është e rëndësishme, që Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të ndëshkojë subjektet me sanksionet e parashikuara nga ligji në rastet e deklarimit të rremë. Gjithashtu, është e nevojshme dhe shpërndarja e informacioneve të mbledhura dhe lehtësira për të gjithë ato subjekte të interesuara për analizimin e tyre. Garantimi i këtyre informacioneve është thelbësor për nxitjen e transparencës dhe për rritjen e besimit të qytetarëve ndaj autoriteteve qeverisëse.

3.3 Mbrojtja e denoncuesve të korrupsionit.

Në mënyrë që të inkurajohen zyrtarët, nëpunësit apo qytetarët për të denoncuar veprime që lidhen me shpërdorimin e detyrës dhe që përbëjnë akte korruptive, rregullimi ligjor i këtij instituti është thelbësor. Në vendin tonë denoncimi i zyrtarëve për korrupsion është ende tabu, ndaj duhet një punë e madhe për ndërgjegjësimin dhe informimin e publikut lidhur me garancitë ligjore në këtë rast. Mbrojtja e denoncuesve të korrupsionit garantohet nga Ligji Nr. 9508, datë 03.04.2006 "Për Bashkëpunimin e Publikut në Luftën Kundër Korrupsionit", si edhe nga një ndryshim i bërë në Kodin e Punës (neni 10/1)**.

Qëllimi i këtij ligji është të nxisë pjesëmarrjen e publikut në denoncimin e korrupsionit, duke mbrojtur e nxitur personat, të cilët denoncojnë praktikën korruptive të abuzimit me autoritetin publik. Ai ka si objekt përcaktimin e rregullave, procedurave e përgjegjësive të zbatueshme në institucionet shtetërore për denoncimin dhe regjistrimin e praktikave korruptive, si dhe shpërblimin e mbrojtjen e personave që denoncojnë.

Garancitë për mbrojtjen e denoncuesve të korrupsionit janë elemente kyç për të promovuar transparencën, pasi nxitja për denoncimin e tij jo vetëm që jep informacion, por dërgon gjithashtu mesazhin që përgjegjshmëria dhe transparenca janë prioritet në qeverisje dhe abuzimet nuk do të tolerohen.

Për të garantuar efektshmërinë e këtij ligji, në administrimin e denoncimeve ai parashikon zbatimin e parimit të konfidencialitetit dhe ruajtjen e anonimatit në rast se kërkohet nga vetë personi.

**Neni 10/1 - Mbrojtja për punonjësit që denoncojnë korrupsionin (Shtuar me ligjin nr.10 053, datë 29.12.2008)

1. Çdo masë ose sanksion administrativ i pajustificuar, që është marrë ndaj punonjësve, të cilët kanë arsye të dyshojnë për korrupsion e që këtë dyshim ua paraqesin personave përgjegjës ose autoriteteve kompetente, është i pavlefshëm.
2. Kundër vendimit të dhënë në mënyrë të pajustificuar për shkakun e mësipërm, punonjësi ka të drejtën e ankimit në gjykatë.
3. Raportimi i fakteve, që kanë lidhje me korrupsionin, nuk përbën shkelje të detyrimit të sekretit profesional.

Gjithashtu, personat që denoncojnë praktika korruptive, kanë të drejtë të përfitojnë shpërblim monetar në përfundim të procesit të hetimit vetëm kur e kanë kërkuar atë sipas këtij ligji dhe kur në përfundim të procesit të hetimit denoncimi rezulton i bazuar, real dhe i panjohur më parë.

Një mekanizëm mjaft i mirë për nxitjen e denoncimit, është dhe ngritja e një linje telefonike të posaçme pranë çdo njësie të qeverisjes vendore, e cila duhet të menaxhohet nga një staf profesionist dhe i trajnuar për këtë veprimtari.

3.4 Kodi i Etikës

Ekzistenca dhe respektimi i një kodi etike përbën elementë të nevojshëm për një qeverisje të mirë. Legjislacioni shqiptar e rregullon këtë institut me anë të Ligjit Nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i cili ka për qëllim të vendosë rregullat e sjelljes së nëpunësve të administratës publike, sipas standardeve të kërkuara, t’i ndihmojë ata për arritjen e këtyre standardeve dhe të vërë në dijeni publikun për sjelljen që duhet të ketë nëpunësi i administratës publike. Ky kod etike përfshin parimet bazë mbi të cilat duhet të mbështetet sjellja e nëpunësve, ndër të cilat përmendim:

- a) të kryej detyrat, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- b) të veprojnë në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike e të mos pengojë zbatimin e politikave, të vendimeve ose veprimeve ligjore të autoriteteve të administratës publike;
- c) në kryerjen e detyrave duhet të jetë i ndershëm, i paanshëm, efikas, duke pasur parasysh vetëm interesin publik;
- ç) të jetë i sjellshëm në marrëdhënie me qytetarët që u shërben, dhe me eprorët, kolegët e vartësit e tij;
- d) nuk duhet të veprojnë arbitrarisht në dëm të një personi ose organizate dhe duhet të tregojë respektin e duhur, për të drejtat dhe interesat personale të të tretëve;
- dh) të mos lejojë që interesat e tij privatë të bien ndesh me pozitën e tij publike, të shmangë konfliktet e interesave dhe të mos shfrytëzojë asnjëherë pozitën për interesin e tij privat;
- e) të sillt gjithnjë në mënyrë të tillë, që besimi i publikut në ndershmërinë, paanshmërinë dhe efektivitetin e shërbimit publik të ruhet e të rritet;
- ë) të ruajë konfidencialitetin e informacionit, që ka në zotërim, por pa cënuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.8503, datë 30.6.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Një aspekt i rëndësishëm në këtë drejtim është dhe njohja e nëpunësve me këto rregulla dhe trajnimi i tyre fillestar apo i vazhdueshëm për respektimin e parimeve dhe procedurave që lidhen me etikën. Në mënyrë që të arrihen rezultate sa më pozitive, çdo njësi e qeverisjes vendore duhet të fokusohet kryesisht në:

- **Zhvillimin e një programi trajnimi për etikën në administratë**, i cili duhet të bazohet në rregullimin ligjor në fuqi për këtë aspekt. Ky program duhet të theksojë gjithashtu rëndësinë për adoptimin e praktikave të mira të etikës, që kanë si objekt final nxitjen e transparencës dhe përmirësimin e qeverisjes.
- **Përcaktimin e burimeve financiarë të disponueshme**, duke patur parasysh cili është buxheti i nevojshëm për këto trajnime, të cilat jo domosdoshmërisht janë të kushtueshme.
- **Përcaktimin e individëve që do të administrojnë trajnimet**, duke përzgjedhur persona të njohur të personelit apo të Departamentit të Administratës Publike, ashtu si parashikohet dhe nga vetë ligji për rregullat e etikës në administratë.
- **Përcaktimin e programit të trajnimit**, në mënyrë që të sigurohet një pjesmarrje sa më e madhe e nëpunësve. Këto sesione mund të bëhen dhe të hapura, duke i dhënë mundësinë dhe publikut që të bëhet pjesë e tyre.
- **Projektimin e një procesi vlerësimi**, që të konkludohet për efektshmërinë dhe arritjet e programit të trajnimit. Në këtë mënyrë mund të analizohet i gjithë procesi dhe të identifikohen ato aspekte që duhen përmirësuar në programet në vazhdim.

4. Reforma Institucionale

Kjo reformë duhet të përfshijë njëkohësisht, riorganizimin dhe thjeshtëzimin e procedurave administrative, si edhe risitë strukturore për të promovuar pjesmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe rritjen e përgjegjshmërisë së zyrtarëve.

Pjesa kryesore e punës së njësive të qeverisjes vendore mbështetet në procedura administrative, që shpesh janë komplekse dhe që zgjasin në kohë. Këto procese lidhen me dhënien e lejeve të ndërtimit, dhënien e lejeve për bizneset, mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore ose me dhënien e shërbimeve të ndryshme sociale. Nëse këto procedura nuk kuptohen drejtë nga publiku, atëherë mund të ndodhemi para komenteve negative të tyre për një vendimmarrje të padrejtë. Po kaq e rëndësishme është që këto procedura të jenë sa më të thjeshta dhe më një përfshirje sa më të ulët të stafit të administratës, në mënyrë që të ulen mundësitë për abuzime.

Si mjete për nxitjen e transparencës nëpërmjet reformave institucionale mund të përmendim:

4.1 Ankesa tek Avokati i Popullit

Në praktikë konstatohen shpesh raste, ku ankesat që lidhen me burokracitë e qeverisjes, të realizuara nga individë apo nga organizata, mbeten pa asnjë zgjidhje. Sistemi ynë ligjor i njeh të drejtën subjekteve që t'i drejtohen gjykatës si instancë e fundit për zgjidhjen e problemeve që kanë, por kjo konsiderohet si një procedurë e ngadaltë, e shtrenjtë dhe që mund të jetë objekt abuzimi. Avokati i Popullit (AP) është një organ kushtetues, i cili shërben si një mundësi për t'i zgjidhur problemet e tilla duke u mjaftuar me kontekstin administrativ, pra pa qënë e nevojshme rruga gjyqësore. Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Ai është një institucion i pavarur që pranon dhe shqyrton (heton) ankesat e individëve, që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat dhe liritë dhe interesat e tyre të ligjshme nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike.

Ekzistenca e një institucioni të tillë është dëshmi për rëndësinë që ka transparenca dhe përgjegjshmëria në qeverisje. Ankesat e drejtuara tek AP ndihmojnë jo vetëm zgjidhjen e rasteve individuale konkrete, por edhe në një kontekst më të gjerë që lidhet me rivlerësimin e integritetit të institucioneve.

4.2 Zyra e mardhënieve me publikun.

Zyra e mardhënieve me publikun pranë çdo njësie të qeverisjes vendore është kontakti i parë i qytetarit me administratën vendore. Kjo zyrë orienton qytetarët se ku duhet të drejtohen apo çfarë formularësh duhet të plotësojnë në mënyrë që të zgjidhin problemet e tyre. Ajo mund të operojë për dhënien e një informacioni dhe asistence të përgjithshme ose mund të ofrojë shërbime në një fushë specifike (ndihma sociale, taksat, liçencat etj.).

Për të patur një funksionim sa më eficient, është e nevojshme që stafi i kësaj zyre të ketë eksperiencën e duhur, si edhe që shërbimi i saj të ofrohet edhe nëpërmjet telefonit apo faqes zyrtare të internetit të njësisë vendore. Stafi duhet të tregohet i sjellshëm dhe mikpritës, pasi ka përgjegjësinë e krijimit të një imazhi pozitiv të njësisë vendore që përfaqëson. Qytetarëve që i drejtohen kësaj zyre duhet t'u sigurohet me lehtësi dhe fleksibilitet asistencë e kërkuar. Zyra e mardhënieve me publikun shërben si një mjet për të rritur informimin e publikut dhe pjesmarrjen e tij në vendimmarrje.

4.3 “One Stop Shop”

“One Stop Shop” nënkupton ekzistencën e një zyre/vendi të vetëm nga ku të ofrohen disa lloje shërbimesh për qytetarin. One Stop Shop ndryshon nga zyra e mardhënieve me publikun nga fakti që, kjo e fundit thjesht jep informacion apo orienton qytetarët, ndërsa e para jep shërbime të mirfillta. Kjo zyrë luan një rol të rëndësishëm në thjeshtëzimin e procedurave dhe në maksimizimin e përdorimit të burimeve të njësive vendore. Nëpërmjet ofrimit të disa shërbimesh, One Stop Shop-i pakëson mundësitë për zvarritje dhe korrupsion, duke rritur përgjegjshmërinë e personelit e për rrjedhojë dhe nivelin e transparencës. Praktika ideale kërkon që kjo zyrë të ofrojë një gamë sa më të gjerë shërbimesh të specializuara, nëpërmjet një stafi të përgatitur dhe mikpritës.

4.4 Funksionimi i një departamenti auditit të brendshëm e të pavarur .

Auditimi i veprimtarisë së njësive të qeverisjes vendore promovon më së miri transparencën në qeverisje. Kontrolli ndaj tyre, i cili në bazë të ligjit ushtrohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, Prefekti (kontroll i jashtëm) dhe auditit i brendshëm i institucionit, fokusohet kryesisht vetëm në veprimtarinë financiare të këtyre njësive të qeverisjes. Praktika më e mirë do të ishte që kontrolli nga auditit i brendshëm të mos kufizohet vetëm në aspektin ekonomik, por të shtrihet dhe në performancën e nënpunësve. Qëllimi kryesor i auditimit është që të verifikojë dhe të konstatojë nëse ka raste abuzimi në të gjitha veprimtaritë apo procedurat e ndjekura nga zyrtarët në ushtrimin e funksioneve të tyre, duke hartuar raporte zyrtare të mbështetura mbi fakte.

Në mënyrë më specifike funksioni i auditit ka këto qëllime:

- Të identifikojë mangësitë dhe pikat e dobëta të strukturave të administratës;
- Të identifikojë bazat për ndërmarrjen e reformave të caktuara;
- Të sigurojë për çdo palë të interesuar një informacion të besueshëm për veprimtarinë e njësisë së pushtetit vendor, duke rritur besimin publik te ky institucion ose duke nxitur reformat për zgjidhjen e problemeve që konstatohen.

Fuqia e vërtetë e departamentit të auditit lidhet me faktin se raportet e tij bëhen publike dhe gjithsecili mund të marrë informacion mbi konstatimet e arritura. Një faktor i rëndësishëm që ndikon në efektivitetin e këtij procesi është zgjedhja e personave që kryejnë këtë funksion, duke patur si kriter një nivel profesional të lartë të ekspertizës dhe të pavarësisë nga çdo lloj influence. Një garanci më shumë për këtë proces është edhe përcaktimi i metodave dhe procedurave standarte, në mënyrë që të shmanget çdo mundësi abuzimi.

Parimi i auditimit shërben në ndërtimin e bazave të transparencës në qeverisje, si edhe në rritjen e përgjegjshmërisë në vendimmarrje. Gjetjet pozitive nga një proces auditimi i pavarur ndikojnë në forcimin e besimit të publikut, ndërsa ato negative shërbejnë si katalizator për ndryshime.

4.5 Buxhetimi me pjesmarrje.

Buxhetimi me pjesmarrje është një praktikë e re financiare, që ndihmon në nxitjen e pjesmarrjes dhe në rritjen e transparencës në administrimin e buxhetit. Ai përbën një mekanizëm që siguron përfshirjen e komunitetit në identifikimin e prioriteteve dhe alokimin e burimeve, në mënyrë që pushteti vendor t'i përgjigjet më së miri nevojave të tyre. Për të qënë sa më efektive në përdorimin e kësaj metode, duhet të vlerësohen paraprakisht këta elementë:

- **Vlera e buxhetimit me pjesëmarrje:** Njësia vendore duhet ta specifikojë qartësisht pjesën e buxhetit që do t'i nënshtrohet buxhetimit me pjesëmarrje, duke e caktuar paraprakisht me votim të këshillit, ose pas procesit, duke u bazuar tek kërkesat e komunitetit dhe tek burimet e disponueshme.

- **Pjesmarrja:** Suksesi i buxhetimit me pjesmarrje bazohet ne shkallën e pjesmarrjes së qytetarëve, qoftë individualisht, ose si përfaqësi e komunitetit ku jetojnë. Nxitja e kësaj pjesmarrje duhet të realizohet duke e informuar publikun lidhur me këtë mundësi, si edhe me temën apo orarin e takimeve që caktohen për këtë qëllim.
- **Nxitja e pjesmarrjes së grupeve në minorancë:** Një nga parimet themelore të këtij procesi është gjetja e mjeteve efektive për të përfshirë minoritetet dhe grupet vulnerabël në të dhe në përfitimet që ai ka. Në përmbushje të kësaj duhet të fokusohemi tek çështje të tilla si: barazia gjinore, grupet etnike apo moshat e ndryshme.
- **Aprovimi final i buxhetit dhe roli i Këshillit të Bashkisë/Komunës:** Eksperienca në mjaft vënde ka treguar, se pas realizimit të buxhetimit me pjesmarrje është i nevojshëm aprovimi i tij nga Këshilli i njësisë vendore, si stadi final i kësaj metode. Para se të aprovohet në mënyrë përfundimtare është e arsyeshme që i gjithë procesi t'i nënshtrohet një seleksionimi paraprak nga një autoritet specifik. Ky autoritet mund të jetë në trajtën e një komisioni ose grupi pune të buxhetimit me pjesmarrje, i cili vlerëson rezultatet e procesit në tërësi dhe harton një draft paraprak që më pas i dërgohet për aprovim final këshillit të njësisë vendore.
- **Komunikimi i rezultateve:** Element kyç i buxhetimit me pjesmarrje është komunikimi i rezultateve përfundimtare, duke informuar komunitetin për projektet që janë vendosur si prioritare, vendndodhjen e tyre, vlerën dhe afatin kohor për zbatimin. Informimi i komunitetit duhet të bëhet duke përdorur të gjitha mjetet e teknologjisë së informacionit, nga shtypi i shkruar deri në publikimin në faqen zyrtare të internetit të secilës njësi vendore. Një mjet tjetër për të shpërndarë informacionin është edhe publikimi i buletinit apo broshurave disa mujore ose vjetore të njësisë vendore, ku të jepet informacioni i nevojshëm për të gjitha projektet në zhvillim ose të përfunduara.
- **Hartimi i mekanizmave ligjorë dhe rregullatorë që institucionalizojnë buxhetimin me pjesmarrje:** Në mënyrë që të kemi një proces të suksesshëm, efektiv dhe të përgjegjshëm, është e rëndësishme që ai të institucionalizohet në mënyrë zyrtare nga pushteti vendor. Kjo mund të bëhet në sajë të një rregulloreje të brëndshme e cila parashikon çdo detaj të këtij procesi si: mënyra e realizimit të tij, koha dhe vendi i organizimit të takimeve me komunitetin, apo grupi i punës që do të angazhohet dhe do të jetë përgjegjës për të.

5. Synimi në çështje të caktuara

Konsiston në përdorimin e çështjeve specifike si pikënisje për rritjen e transparencës. Këto çështje duhet të jenë të rëndësishme në terma të zhvillimit lokal dhe duhet të kenë potencialin që të shërbejnë si pikënisje për ndryshime pozitive në qeverisjen vendore. Të njëjtat çështje mund të kenë gjithashtu lidhje me fenomenin e korrupsionit.

Në përfundim, transparenca duhet parë si një pikë nisje strategjike për nxitjen e pjesëmarrjes publike dhe promovimin e qeverisjes së mirë vendore. Përpjekjet e mbështetura në parimet bazë të qeverisjes së mirë vendore, janë strategjia më efektive për rritjen e përgjegjshmërisë dhe uljen e nivelit të korrupsionit në nivel lokal. Forcat e urbanizimit, globalizimit, decentralizimit dhe demokratizimit, krijojnë një klimë ndryshimesh të shpejta, që ofrojnë një sërë mundësish dhe sfidash. Një nga sfidat më të mëdha në këtë periudhë tranzicioni, është shmangia e krijimit të një sistemi të qeverisjes, i cili ofron stimuj të gabuar që nxisin sjelljet korruptive.

FOTO NGA AKTIVITETET ME BASHKITË E PËRFSHIRA NË PROJEKT







Transparency International Albania
Bul. "Gjergj Fishta", Projekt 2000, Kulla V(blu), Kati 2, Nr.6, Tiranë
Tel: +355 42 267 457
E-mail: info@tia.al